



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 9.7.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT URBANE DHE RURALE, FAZA E DYTË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.86, DATË 23.07.2015”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë, ratifikuar me ligjin nr.86, datë 23.07.2015””, në mbledhjen e datës 9 korrik 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji ka si qëllim shfuqizimin dhe denoncimin e marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Marrëveshja do të funksiononte nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe do të monitorohej nga KfW-ja, e cila gjatë periudhës shtator 2015-2016 ka kontaktuar periodikisht bankat e nivelit të dytë për të mundësuar bërjen efektive të linjës së kredisë, por pa sukses, për shkak të mungesës së garancive nga ana e kredimarrësve, pra SME-ve, që duhet të vendosnin pranë këtyre bankave.

Marrëveshja që nga miratimi i saj nuk është bërë asnjëherë aktive dhe për këtë arsye është propozuar nga pala gjermane një projekt marrëveshje e re për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive”, duke vënë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, duke mbështetur dhe promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale.

Në kuadër të bashkëpunimit financiar qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përmes bankës gjermane për rindërtim KfW, do të vërë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF)”, por realizimi i këtij projekti kushtëzohet nga lidhja e një marrëveshjeje të re mes dy qeverive.

Për t’i bërë këto fonde të disponueshme Republika Federale e Gjermanisë ka propozuar anulimin me dakordësi të ndërsjellë të marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Rrahman RRAJA

Relator

Eduard SHALSI

Kryetar